

KESH SH.A
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “S.M.O UNION” sh.p.k me NIPT: J66902042Q, dhe adresë: Beltoje, Shkodër.

Procedura e Prokurimit: Procedurë e Hapur, me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-79674-07-18-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “EVADIMI I MATERIALEVE TË NGURTA NË ZONËN POSHTË URËS SË DERI TEK BASHKIMI ME LUMIN E VALBONËS NË HEC FIERZË”.

Fondi limit: 183,482,141 (Njëqind e tetëdhjetë e tre milion e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e një) Lek pa TVSH.

Burimi i financimit: Me të ardhurat e vetë KESH sh.a.

Kontrata do të realizohet në një afat: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 29, datë 23.07.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se kanë qenë pjesëmarrës 5 (pesë) Operatorë Ekonomik me vlera të ofertave respektivisht:

- 1) BOE “GJOKA KONSTRUKSION” sh.a, NIPT J91815014U & “SELAMI” sh.p.k, NIPT J77304706L, me vlerë të ofertës 136,646,496 Lek pa TVSH;
- 2) “S.M.O UNION” sh.p.k, NIPT J66902042Q, me vlerë të ofertës 142,881,412 Lek pa TVSH;
- 3) OE "4 A-M" sh.p.k, NIPT K92005016L, me vlerë të ofertës 149,473,653 Lek pa TVSH;
- 4) BOE “Nika” sh.p.k, NIPT J76705047U & “Kthella” sh.p.k, NIPT J69303023D & “Riviera” sh.p.k, NIPT J66903244D, me vlerë të ofertës 157,785,217 Lek pa TVSH;
- 5) BOE “SHANSI INVEST” sh.p.k, NIPT J61924002T & “BIBA-X” sh.p.k, NIPT K32618815 me vlerë të ofertës 168,666,645 Lek pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomik :

BOE “Gjoka Konstruksion” sha & “Selami” shpk me vlerë të ofertës 136,646,496 Lek pa TVSH, skualifikohet pasi :

- 1) Sipas vërtetimit Nr.305 Prot., datë 17.08.2018 lëshuar nga OSHEE për kontratën me Nr. BU0C130065044739, “Selami” shpk rezulton me debi në vlerën 123,512.80 lekë, e cila është në kundërshtim me VKM 914/2014, neni 26/7-c.

- 2) Sipas kontratës së bashkëpunimit “Selami” SHPK do të realizojë “punime germimi dhe sistemimi në ujë për të cilat kërkohet Licensa NP-9. “Selami” shpk nuk disponon pikën e licensës NP-9 dhe si rrjedhojë nuk është i licensuar për këto punime.
- 3) Në marrëveshjen e bashkëpunimit OE “Gjoka Konstruksion” sha do të realizojë 97.88% të punimeve. Duhet të ketë një inxhinier Hidroteknik pasi do të kryejë shumicën e punimeve. Inxhinierët Hidroteknik Andri Duni dhe Esmeralda Halili të paraqitur nga “Gjoka Konstruksion” sha nuk rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar-Qershor 2018. Gjithashtu, Andri Duni është diplomuar me 16.7.2014 dhe nuk plotëson kriterin për 5 vite eksperiencë pune.
- 4) Dokumentacioni i paraqitur nga OE “Selami” shpk për Erlin Koçia si Inxhinieri Hidroteknik vërteton se inxhinieri hidroteknik Erlin Koçia nuk plotëson kushtin e 5 viteve eksperiencë pune, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- 5) Operatorit Ekonomik "Selami"sh.p.k., deklaroi si drejtuesin teknik Ing. Erlin Koçia ndërkohë që ky inxhinier nuk rezultoi si drejtues teknik në licencën e vetë operatorit ekonomik për punimet e zbatimit, kërkesë e kriterëve për kualifikim.
- 6) Ofertuesi nuk plotëson kriterin për punonjësit e pajisur me certifikatë për punime në lartësi (DST, Kapaciteti Teknik Pika 7). Pas verifikimit në sistemin on-line të Entit Certifikues (sipas udhëzimit të vetë këtij enti për verifikimin e certifikatave që lëshon), numri serial i certifikatës së punimeve në lartësi të paraqitur nga Ofertuesi për inxhinierin elektrik Bardh Gj. Kola rezultoi të jetë lëshuar ndaj një personi tjetër.
- 7) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "Gjoka Konstruksion" sha dhe “Selami” shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11/3). BOE ka paraqitur kontratë qiraje të lidhur më datë 18.08.2018 me “VELLEZERIT HYSA” sh.p.k për të marrë me qira dy mjete “eskavator me kavo me krah të gjatë minimumi 20 m, me peshë mbi 25 ton, të paisur me kovë dhe greifer me kapacitet minimumi 1 m³”. Dokumentacioni (deklaratat e zhdoganimit, urdhër çlirimi, fotografi etj.) i paraqitur për dy mjetet e sigurara nëpërmjet kontratës së qirasë (JSB JS 220 dhe LiebHerr R954B) vërteton se mjetet janë eskavatore me zinxhir me peshë 23Ton me krah të gjatë dhe jo Eskavator me Kavo me peshë 25Ton siç kërkohet në DT.
- 8) Çertifikata ISO 50001 -2011, e Operatorit Ekonomik "GJOKA Konstruksion" sh.a, Çertifikata ISO 50001 -2011, e Operatorit Ekonomik “SELAMI” sh.p.k, dhe Certifikata ISO 3834:2006 e Operatorit Ekonomik “SELAMI” sh.p.k, nuk është e akredituar nga DPA, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, datë 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).

“4 A-M” shpk me vlerë të ofertës 149,473,653 Lek pa TVSH, skualfikohet pasi :

- 1) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin e kërkuar për staf teknik. Inxhinier Mjedisi (Mirel Mico) i përfshirë në licencën e OE rezultoi të jetë njëkohesisht pjesë e stafit pedagogjik të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) në kundërshtim me VKM Nr.42 datë 16/01/2008, Kreu IV, Pika 2 - “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit.
- 2) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin e kërkuar për punë të ngjashme (DTS, Kap 2.3-kapacitetin teknik, pika 1). OE ka paraqitur dokumentacion (kopje kontratash dhe vërtetim realizimi punimesh) për pesë kontrata të ngjashme nga ku rezultoi se për katër nga kontratat e paraqitura OE nuk ka realizuar asnjë volum punimesh të ngjashëm me zerin “Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale, në prani uji, kategoria III “ apo me zerin “Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave”. Në kontratën e pestë ”Mbrotjtja e tubacioneve DN 650, DN 600, DN 350 ne sektorin 5, në shtratin e Perroit të Selites dhe ne Gurore” me vlere

17,709,875.40 Leke (pa T.V.SH), OE rezulton se ploteson me punime të ngjashme vetëm afërsisht 3.47% të volumit të kërkuar në DST për zërin “Germim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale, në prani uji, kategoria III” dhe afërsisht vetëm 11.9% të volumit të kërkuar në DST për zërin “Gabiona me rrjete teli te zing, gure kave”.

- 3) Çerifikatat ISO 3834:2006, e Operatorit Ekonomik "4 A-M" shpk, të lëshuara nga AQS Çert., nuk është e akredituar nga Drejtoria e Akreditimit, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, date 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).
- 4) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11/3). Kontrata e qirasë lidhur me OE "SOND Emigranti" shpk, për makinerinë “Eskavator me krahë të gjatë mbi 20m, dhe peshë 25T, të pajisur me kovë dhe grejfer 1 m³” është e pavlefshme pasi fatura tatimore për pjesët përbërëse nuk është e firmosur nga blerësi, akti i zhdoganimit specifikon se mjete është eskavator i përdorur, jashtë përdorimit, i zbërthyer me 4 pjesë+aksesorë me peshe 23Ton, në kundërshtim me sa kërkohet në kriteret për kualifikim.
- 5) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11/3). Kontrata e qirasë Nr. 5329 Rep, dhe Nr.1026 Kol., datë 17/08/2018, lidhur me Operatorin Ekonomik "REDI" shpk, për makinerinë “eskavator me krahë të gjatë mbi 18 m”, është e parregullt pasi nuk ka asnjë dokumentacion që të vertetojë se mjete objekt qiraje është në pronësi të “REDI” shpk dhe periudha e qirase nuk mbulon të gjithë periudhën e zbatimit të punimeve pasi kjo kontratë është lidhur për 10 muaj dhe jo 12 muaj që kërkohet në dokumentat e tenderit.
- 6) Operatori Ekonomik "4 A-M" shpk nuk plotëson kriterin për kapacitetet teknike (DST, Kap 2.3, pika 11/4). Kontrata e qirasë Nr. 5330 Rep, dhe Nr.1027 Kol., datë 17/08/2018, lidhur me Operatorin Ekonomik "DIBRANI" shpk, për makinerinë “eskavator me krahë të gjatë mbi 18m”, nuk është me objekt tenderi, kërkesë e kriterëve për kualifikim.

BOE “Nika” shpk & “Kthella” & “Riviera” shpk me vlerë të ofertës 157,785,217 Lek pa TVSH, skualfikohet pasi :

- 1) Bashkimi i Operatori Ekonomike "Nika" shpk & "Kthella" shpk & Riviera" shpk nuk plotëson kriterin e kërkuar për punë të ngjashme (DTS, Kap 2.3-kapacitetin teknik, pika 1) pasi Operatori Ekonomik "Riviera" sh.p.k për kontratat e ngjashme të deklaruara në oferte nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë sipas kërkesave të DT, me specifikisht nuk ka paraqitur certifikatë e marrjes në dorëzim, kopje e kontratës së lidhur ndërmjet "Riviera" sh.p.k dhe ARSH, kopje të kontratave të lidhur nga "Riviera" sh.p.k me Bashkinë Përmet, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Fier, Bashkinë Berat.
- 2) Riviera sh.pk nuk plotëson kushtin në lidhje me pikën e licensën NP-9D të kërkuar nga AK, ajo zotëron NP-9A e cila nuk përmbush kriterin për kapacitet të nevojshëm. Sipas Akt-Marrveshjes për bashkimin e përkoshëm të shoqërive në të cilën është deklaruar përqindja dhe punimet të cilat operatorët marrin përsipër, Riviera sh.p.k deklaroi se do të realizojë 70.3 % të punimeve për të cilën nuk ka pikat e kërkuara të licensës.
- 3) Operatori Riviera sh.p.k nuk plotëson kriterin 4 ku kërkohet që OE të ketë të paktën 80 punonjës në listepagesa për periudhën Janar–Qershor 2018, ku në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit meqë nuk është specifikuar ndryshe ky OE duhet të kishte 70.3% të kapacitetit teknik për numërin e kërkuar të punonjësive pra 56 punonjës dhe jo 51 punonjës).

- 4) Riviera sh.p.k bazuar në kontratën e bashkëpunimit nuk plotëson kriterin nr 7 ku kërkohen të paktën tre punonjës me certifikata D.P.I ku te paktën njëri të jetë inxhinier, pasi Riviera e cila do të kryejë 70.3% të punimeve ka vetëm një punonjes elektrikist (Besnik Hoxha).
- 5) 2 inxhinierëve të Operatorit Ekonomik "NIKA" shpk, i ka skaduar liçensa ISHTI me 18.05.2018. Konkretisht Ing.Gentiana Mosko e dhe Ing. Arben Kruja, Ing. Gentiana Mosko, është deklaruar nga ofertuesit si drejtuese teknike e kantierit e cila do të ndjek punimet çdo ditë nëse shpallet fitues, pra nuk plotëson numrin e inxhinjerve me liçensë ISHTI në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, kërkesë e VKM 914/2014 Nenini 74-3.
- 6) Kontrata e Qerasë të lidhura ndërmjet "NIKA" shpk dhe Armad Gremi, "Pako" sh.p.k, "Alba Beton 07" sh.p.k, "Berdica" sh.p.k, "Brajan-Ab"sh.p.k nuk janë lidhur sipas kërkesave të kriterëve për kualifikim të DT, pasi nuk janë me objekt tenderi dhe të shtrira në kohë përtej afatit të përfundimit të zbatimit të punimeve, si pasojë nuk plotësohen kërkesat e kriterit Nr 11, shtojca 10, për posedimin e makinerive dhe pajisjeve të deklaruara në këto kontrata, dhe konkretisht :
 - a) Eskavator me zinxhire me peshe mbi 25 Ton dhe me krah të gjatë mbi 18 m;
 - b) Eskavator me kavo dhe me krah të gjatë minimumi 20 m, me peshë mbi 20 Ton, i pajisur me kovë;
 - c) Pompë stacionere mbi 6 Ton;
 - d) Motosaldatrice;
 - e) Rimorkiator
- 7) Autompompa e betonit me targë SH7983E në lejen e qarkullimit rezulton të jetë karroceri dhe jo autopompë.
- 8) Në piken 10 te DT janë kërkuar 4 copë betoniere 0.25-0.33 m3. Vetëm 2 betoniere të paraqitura nga Riviera sh.p.k i plotësojnë këto specifika, e cila është e pamjaftueshme për plotësimin e kriterit.
- 9) Nuk është paraqitur dokumentacion për posedimin apo kontratë qeraje e vlefshme për gjenerator 200KVA, gjeneratorët e paraqitur janë me kapacitet me te vogël.
- 10) Çerifikatat ISO 3834:2006 e OE "NIKA" shpk dhe ajo e OE "KTHELLA" shpk, të lëshuara nga AQS Çert., nuk janë të akredituara nga Drejtoria e Akreditimit, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, date 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).

BOE "Shansi Invest" shpk & "BIBA X" shpk me vlerë të ofertës 168,666,645 Lek pa TVSH, skualifikohet pasi;

- 1) Operatori Ekonomik "Biba X" shpk, në liçensën e zbatimit të punimeve i mungon kategoria NP-9-A, punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Sipas kontratës së bashkëpunimit do të kryej punime lumore, në shtratin e lumit. pra Operatori Ekonomik Biba X" shpk, nuk është i liçensuar për kryerjen e këtyre punimeve. Kërkesë e VKM 914/2014 Neni 74/3.
- 2) Për Muajin Prill 2018, Listepagesa e Operatori Ekonomik "Biba X" shpk, është e palexueshme dhe nuk vërtetohen a janë apo jo në listëpagesa inxhinieret Gjeodet Bajram Muji dhe Inxhinieri i Mjedisit, Fatjona Levani.
- 3) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SHANSI INVEST" shpk dhe "Biba X" shpk, nuk plotëson kriterin për një Ing. Gjeolog me eksperiencë 10 vite punë. Operatori Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për inxhinier gjeolog me eksperience 10 vjet,

- dhe Operatori Ekonomik "Biba –X" shpk, për inxhinierin Gjeolog Agim Hasalamaj nuk vërteton eksperiencën 10 vjeçare, as në CV dhe as në librezën e punës e paraqitur në këtë ofertë.
- 4) Për inxhinierin gjeodet të Operatori Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k rezultojnë se kontrata dhe CV dhe diplomë janë në emër Kajtaz Rataj, i cili është diplomuar në vitin 1976, ndërsa në licensë është me emrin Kajtaz Alikaj, dhe në të deklarohet se diplomimi është bërë në vitin 1977. Nuk vërtetohet as nëpërmjet vërtetimit se është i njëjti person.
 - 5) Operatori Ekonomik "Biba X" shpk., sipas kontratës së bashkëpunimit dhe zërave të punimeve që do të kryej secili anëtar i këtij JV, rezultojnë se do të kryej 20% të punimeve për çdo zë të preventivit, si e tillë ky OE duhet të plotësojë 20% të kapacitetit ekonomik dhe teknik për kryerjen e këtyre punëve. VKM 914/2014 Nenini 74-3. Nga verifikimi i dokumentacionit për makineri dhe pajisje nuk plotësohet ky kriter dhe konkretisht:
 - a) Nuk plotëson kushtin për të paktën 1 (një) kaminon me peshë mbajtëse 10-20 Ton, pasi nuk ka asnjë të tillë.
 - b) Nuk plotëson kushtin për të paktën 1 (një) eskavator me krah jo më pak se 18m pasi nuk ka asnjë të tillë.
 - 6) Operatori Ekonomik "Shansi Invest" shpk, nuk plotëson kushtin për kamionët me peshë mbajtje 10-20 t pasi për mjetet me tragë AA503PT, KO0119B, KO9407B, për të cilat është lidhur kontratëqiraje me Nr.1453 Rep., dhe Nr.727 Kol, datë 09.08.2015, me subjekti "MILENIUM" shpk rezultojnë të jetë e pavlefshme pasi për këtë kamionë subjekti qiradhënës "MILENIUM" shpk ka lidhur kontratë qiraje me Operatorin Ekonomik "NIKA" shpk.
 - 7) Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "SHANSI INVEST" shpk & "Biba X" shpk, nuk plotëson kushtin për impjant të prodhimit të betonit, pasi këtë impjant që ka paraqitur në ofertë operatori ekonomik "BIBA X" shpk, subjekti qiradhënës "BIBA X" shpk e ka dhënë me qira Operatorit Ekonomik 4-A-M shpk (ofertues në këtë garë)
 - 8) Nuk është paraqitur dokumentacion për Motorsaldatrice, dokumentacion është paraqitur vetëm për saldatrice.
 - 9) OE "Biba X" shpk nuk ka paraqitur Certifikatën ISO ISO 3834:2006.
 - 10) Çerifikatat ISO 3834:2006, të Operatorit Ekonomik "SHANSI INVEST" shpk, të lëshuara nga AQS Çert., nuk janë të akredituara nga Drejtoria e Akreditimit, kriter për kualifikim siç përcaktohet në DT (bazuar në Udhëzimin e APP-së Nr.3330, date 20.03.2018 dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit Nr.145, datë 16.03.2018).

II-Është kualifikuar si e vlefshme, oferta e ofertuesit "S.M.O UNION" sh.p.k pasi ka paraqitur ofertën konform kërkesave të Dokumentave të Tenderit.

* * *

Duke i'u referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "S.M.O UNION" sh.p.k me NIPT: J66902042Q, dhe adresë: Beltoje, Shkodër, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 142,881,412 Lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a, në adresë: Rr.Viktor Eftimiu, Blloku "Vasil Shanto", sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 31/08/2018.

Ankesa: Po.

Kanë marrë përgjigje në datë: 12.09.2018

Ankesa në KPP: Jo.

